

PROF. DR. SHKËLZEN RAÇA**(1951-2014)**

Profesor Shkëlzen Raça u lind më 1 janar të vitit 1951 në Skenderaj në një familje intelektuale e arsimdashëse. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë, sikundër edhe studimet në Degën e Historisë. Në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, më 1977 mbrojti tezën e magjistraturës, të titulluar *Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe Revolucioni Xhonturk*, ndërsa më 1987 edhe temën e doktoraturës të titulluar *Marrëdhëniet shqiptaro-greke (1829-1881)*. Për një kohë të shkurtër punoi si mësimdhënës në shkollat e mesme, ndërsa nga viti 1977 u punësua në Degën e Historisë të Institutit Albanologjik, ku edhe dha kontributin e tij më të madh historiografik.



Është thënë shumë herë se historia e shqiptarëve mund të njihet në plotësinë e saj vetëm nëse trajtohet në kontekstin më të gjerë ballkanik, pra duke i parë zhvillimet historike të ndërlidhura në fatet e kombeve të ndryshëm.

Dhe pikërisht Profesor Shkëlzeni ishte ndër historianët e paktë që ia doli ta vinte të kaluarën e shqiptarëve në këtë kontekst, në saje të njohjes së gjuhëve, në saje të kulturës së gjerë që zotëronte, në saje të njohjes së shkëlqyeshme edhe të historisë të kombeve në fqinjësi, të qartësimit të marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve dhe kombeve të tjerë, ku spikasin marrëdhëniet me grekët. Me një përgatitje të këtillë, ai kishte zotësinë që të përballte të vërtetën për kombin e tij me të pavërtetat, që nga historiografi ballkanase e më gjerë sajoheshin me tendencën e zhvlerësimit të gjenezës dhe të rolit historik të shqiptarëve në Ballkan. Janë të shumta konferencat shkencore, ku Profesor Raça argumentoi kontekstin në të cilin shqiptarët mbijetuan, krijuan e ruajtën vlerat e tyre identitare, historike e kulturore.

Dija e mirëfilltë shqiptare ka gjetur në veprën e Profesor Shkëlzenit një kontribut të rrallë shkencor, pa asnjë dyshim njëren ndër shenjat identifikuese të studimeve tona moderne. Ai është kalibër intelektual me të cilin historiografia jonë mund të matet me arritjet e simotrave të kombeve më të përparuara, ishte një dijetar që denjësisht përfaqësonte të kaluarën tonë dhe që shkencërisht ia dilte ta argumentonte atë.

Pjesa më e madhe e kontributit shkencor të Prof. Shkëlzen Raçës është përmbledhur në monografitë e botuara në edicionin e Institutit Albanologjik të Prishtinës. E para në radhë është vepra *Marrëdhëniet shqiptaro-greke 1829-1881*, e botuar më 1990, e cila përveçse kontribut për një materie të veçantë, historiografisë sonë mund t'i shërbejë edhe si një model i studimit të relacioneve historike ndërmjet shqiptarëve dhe kombeve të tjerë. Se cila ishte rëndësia e saj dëshmon edhe fakti se ky studim u botua në tirazhin rekord për një vepër shkencore, përkatësisht në 4000 kopje, që aktualisht përbën tetëfishin e tirazhit të botimeve shkencore ndër ne. Vepra vijuese *Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi në shek. XIII – XVI*, botuar më 2004, është po kështu një arritje e madhe e tij, rëndësia e së cilës kap dimensionin e përgjithshëm për albanologjinë. Duke dëshmuar me dokumente bindëse shtrirjen e shqiptarëve pothuajse gjithandej Greqisë, Profesori ynë i nderuar i jep një goditje teze mashtruese sllave e greke për kinse ekspansionin e shqiptarëve në Ballkan. Janë të pakta veprat që e trajtojnë periudhën e mesjetës, por edhe më të pakta janë ato që e trajtojnë me një nivel të këtyllë dokumentues e argumentues. Vepra e fundit *Gjurmime në historinë shqiptare*, e botuar më 2009, është një përmbledhje e shumë kontributeve studimore, publicistike-historike, vlerësime, pikëpamje etj., të cilat jo rrallë Profesori i kishte si një mjet të fuqishëm për t'i dalë në krah, me dijen shkencore, çështjes shqiptare, veçmas duke demaskuar përpjekjet e qarqeve të caktuara greke që bëheshin me qëllimin e përvetësimit të besimit, të kulturës dhe të historisë së shqiptarëve të besimit ortodoks.

Pa dyshim ndër rezultatet më të çmuara të punës kërkimore-shkencore të Profesor Shkëlzen Raçës është edhe zbulimi i Evëtarit të dytë të Naum Veqilharxhit, nxjerrja në dritë e të cilit e ka plotësuar kulturën shqiptare të periudhës së Rilindjes me një argument të fuqishëm të vetëdijesimit të asokohshëm kombëtar të shqiptarëve. Kushdo që do ta zbulonte, kam përshtypjen se gjithë jetës do të mburrej me një rezultat të këtyllë, ndërsa Profesor Xeni, sikurse e quanim të gjithë ne, kolegët e tij, me një modesti të pashoqe, rrallëherë e përmendte, madje e theksonte vetëm si një shërbim për kulturën shqiptare.

Të shumta janë vlerësimet e punës shkencore të Prof. dr. Shkëlzen Raçës, veprat e të cilit janë përruar e çmuar si arritje për mbarë historiografinë tonë. Pjesë e këtij vlerësimi ishte edhe propozimi që Këshilli Shkencor i Institutit Albanologjik ia bëri për anëtar të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Profesor Pëllumb Xhufi, recensuesi i parë, bashkë me kolegët e tij profesorët Xheladin Shala dhe Hamit Kaba, në rekomandimin e tyre shpreheshin: “Ne jemi të bindur se me Prof. Raçën si anëtar të saj, Akademia e Shkencave dhe e Arteve do të ketë një zë më shumë, të aftë e kompetent, t'iu japë përgjigje në nivelin më të lartë shkencor çështjeve të historisë sonë kombëtare, posaçërisht të atyre që lidhen me marrëdhëniet shqiptaro-greke”. Ndonëse zëri i aftë e kompetent shkencor i Profesorit nuk iu desh Akademisë,

jam i bindur se ndër breza do t'i shërbejë historiografisë sonë. Historia do të jetë vlerësuesja më e denjë e birit të saj, i cili për të, për historiografinë shqiptare, pa asnjë kursim, shkriu gjithë jetën dhe gjithë potencialin intelektual.

Pikëllimi ynë është i madh, dhembja për një humbje të këtillë është tronditëse, për familjen në rend të parë, farefisën, miqtë, por edhe për ne si kolegë e si Institucion në të cilin Profesor Shkëlzeni kaloi një pjesë të madhe të jetës. Me Institutin, ai nuk ishte i lidhur vetëm profesionalisht, ishte shpirtërisht i përkushtuar, ndaj largimi i tij natyrshëm na prek në shpirt. U largua nga kjo botë, duke pasur deri në çastet e fundit preokupim përcaktimin e tij jetësor - punën studimore, më pak të tijën dhe më shumë atë të kolegëve, ndaj edhe diskutimet e fundit që i bëmë me të nuk ishin të lidhura me gjendjen e tij shëndetësore, por me materiet e me rezultatet studimore, të cilave me aq bujari ua fali pjesën më të madhe të jetës së tij të shkurtër.

Veçmas e vlerësojmë si një humbje të madhe faktin se po largohet nga ne të gjallët në kohën kur mund të ofronte edhe më shumë, po largohet pikërisht në zenitin e tij shkencor e intelektual. Në atë zenit të shkëlqimit të tij profesional e njerëzor dhe me krenarinë se e patëm në mesin tonë një personalitet të këtillë, do ta kujtojmë gjithmonë shkencëtarin, kolegun e mikun tonë të dashur, Profesor Shkëlzen Raçën.

Hysen Matoshi

Drejtor i Institutit të Albanologjisë - Prishtinë